

ZËRI I POPULLIT RRETH
'SHTEGUT
TË PAQES'

NDËRMJET

KOSOVËS DHE SERBISË:

Shpalosja e Rolit të Grave



Qershor 2024

Mbështetur nga:





www.ridea-ks.org

***Zëri i Popullit rreth 'Shtegut të Paqes'
ndërmjet Kosovës dhe Serbisë:
Shpalosja e Rolit të Grave***

Qershor 2024

Zëri i Popullit rreth ‘Shtegut të Paqes’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Shpalosja e Rolit të Grave

Ky sondazh u mbështet nga:



Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Qershor 2024

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	1
1. Hyrje.....	9
2. Metodologjia	11
2.1. Dizajni i Sondazhit.....	11
2.2. Procedura e Sondazhit	11
2.3. Mostra	12
2.4. Karakteristikat e Mostrës	14
2.5. Analiza e të dhënave	17
3. Gjetjet.....	17
3.1. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.....	18
3.2. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	23
3.2.1. Mbështetja për marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit	23
3.2.2. Mbështetja për kompetencat e zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe	25
3.3. Mbështetja për përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës.....	29
3.3.1. A duhet të ekipi i Kosovës të përfaqësohet vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë?	29
3.3.2. A duhet që qeveria e Kosovës të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë në ekipin e dialogut?.....	31
3.4. Përfaqësimi i grave në ekipin e dialogut të Kosovës.....	34
3.5. Faktorët potencial si frenues të pjesëmarrjes së grave në procesin e dialogut	37
4. Analiza bazuar në dallimet gjinore.....	40
5. Përfundime.....	42

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij sondazhi është identifikimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe rolin e grave në këtë proces. Ky sondazh është zbatuar nga data 27 maj deri më 3 qershor 2024. Numri i përgjithshëm i 1108 respondentëve në sondazhin tonë (89% shqiptarë, 9% serb dhe 2% nga grupet tjera etnike) e përbëjnë mostrën tonë përfaqësuese kombëtare të popullsisë së Kosovës.

Në këtë sondazh, për secilën komunë është përdorur *mostra e thjeshtë proporcionale*, bazuar në numrin e popullsisë së komunës respektive. Pyetësi është përbërë nga pyetjet e tipit të hapur dhe mbyllur. Rreth 15% (167 respondentë) janë riintervistuar për të verifikuar punën e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave. Ky verifikim është bërë përmes intervistave telefonike ose vizitave në terren. Si kontroll, respondentët janë pyetur 5 pyetje bazuar nga intervistimi në terren. Kjo listëkontrolli ka shërbyer si mjet rishikues për verifikim të rregullave të përcaktimit të rastësishëm të vendit, pikënisjes, njësisë së shtëpisë, dhe përzgjedhjes së respondentëve. Përgjigjet nga intervista e parë dhe e dytë janë krahasuar. Përveç selektimit të zakonshëm për riintervistim, është zbatuar një kontrollim logjik i plotësisë të pyetësorëve. *Kufiri (margjina)* i gabimit të matjeve prej 95% nga mostra e përgjithshme është përafërsisht +/- 3 pikë përqindjeje (në nivel të pesë përqind të rëndësisë statistikore). Sidoqoftë, intervalet e konfidencës për vlerësimet e bazuara në nëngrupet e mostrës, siç është mostra serbe prej 100 të anketuarve, do jenë dukshëm më të mëdha.

Sa i përket rezultateve, në paragrafët e mëposhtëm paraqiten gjetjet për çështjet vijuese:

- i)** Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- ii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëveshjen më të fundit të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shkurt, 2023) dhe aneksin e saj të zbatimit të arritu në Ohër (mars, 2023), dhe

- çështja që ka të bëjë me dhënien eventuale të kompetencave të shtuara ekzekutive për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe, është adresuar;
- iii) perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës dhe përfshirja e aktorëve të tjerë, me përqendrim të veçantë te gratë si përfaqësuese/ndërtuese të paqes;
 - iv) arsyet kryesore për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes në lidhje me pikat e shtruar më lartë nën *i*, *ii*, dhe *iii*; dhe
 - v) faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut.

Grupi i parë i gjetjeve ekspozon se pjesa më e madhe e popullsisë në Kosovë nuk është e kënaqur me procesin e dialogut aktual. Në përgjithësi, **49%** nga të gjithë respondentët nuk janë të kënaqur me procesin aktual të dialogut. Si shqiptarët ashtu edhe serbët shfaqin pakënaqësi me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pakënaqësia për procesin aktual të dialogut është më e vogël në mesin e shqiptarëve, por që edhe një numër i rëndësishëm nga mostra shqiptare (26%) dhe serbe (17%) nuk kanë pasur ndonjë mendim lidhur me këtë pyetje. **46%** nga shqiptarët dhe **80%** nga serbët ishin 'shumë të pakënaqur' ose 'të pakënaqur' në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Poashtu, grupi i parë i gjetjeve është përqendruar në arsyet e mundshme rreth kënaqësisë ose pakënaqësisë me procesin e dialogut. Këto janë rezultatet në lidhje me arsyet e të qenit i **kënaqur** me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë:

- Procesi aktual i dialogut së paku garanton paqe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (68% e shqiptarëve përkundrejt 67% të mostrës serbe);
- Procesi aktual i dialogut së paku ndalon dëbimin e serbëve nga Kosova (50% e shqiptarëve përkundrejt 67% të mostrës serbe);
- Procesi aktual i dialogut së paku mban hapur mundësinë për ndikim të fortë serb në disa pjesë të Kosovës (35% e shqiptarëve përkundrejt 67% të mostrës serbe);
- Procesi aktual i dialogut së paku lejon prosperitet ekonomik në Kosovë (64% e shqiptarëve përkundrejt 33% të mostrës serbe);

- Procesi aktual i dialogut mirëmban raporte të mira puna me BE-në dhe OKB-në (65% e shqiptarëve përkundrejt 33% të mostrës serbe).

Në vijim janë rezultatet për arsyet e të qenit **i pakënaqur** me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë:

- Nuk ka perspektivë për hapa konkret drejt integritimit Evropian (60% e shqiptarëve përkundrejt 68% të mostrës serbe);
- Është e pamundur të arrihet njohje globale e Kosovës në rrethanat aktuale (64% e shqiptarëve përkundrejt 74% të mostrës serbe);
- Pavarësia e Kosovës nuk do të njihet nga Serbia në rrethanat aktuale (74% e shqiptarëve përkundrejt 79% të mostrës serbe);
- Nuk do të ketë prosperitet ekonomik në 3-5 vitet e ardhshme (54% e shqiptarëve përkundrejt 73% të mostrës serbe);
- Nuk është e mundur të kemi raporte paqesore me Serbinë në status kuonë aktuale (68% e shqiptarëve përkundrejt 51% të mostrës serbe);
- Problemet e brendshme mes komunitetit shqiptarë dhe serbë nuk mund të zgjidhen në rrethanat aktuale (63% e shqiptarëve përkundrejt 91% të mostrës serbe).

Sa i përket çështjes nëse Dialogu duhet të vazhdoj edhe në pesë vitet e ardhshme në formatin aktual, **45%** nga mostra e përgjithshme treguan mbështetje 'deri diku' ose 'tepër shumë'. **44%** e shqiptarëve dhe **42%** e serbëve u përgjigjën me "deri diku" ose 'tepër shumë' mbështetje për vazhdimin e Dialogut për pesë vitet e ardhshme në formatin aktual. Megjithatë, një numër i rëndësishëm nga mostra shqiptare nuk patën ndonjë mendim për këtë çështje (24%).

Grupi i dytë i gjetjeve lidhet me perceptimin dhe preferencat e qytetarëve të Kosovës dhe arsyet e mundshme për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes për **marrëveshjen më të fundit të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shkurt, 2023) dhe aneksin e saj të zbatimit të arritur në Ohër (mars, 2023).**

Pra, **në lidhje me marrëveshjen më të fundit të Brukselit, 43%** nga mostra e përgjithshme ishin të 'pakënaqur' ose 'shumë të pakënaqur' me të. **16%** në mesin

e shqiptarëve dhe **6%** në mesin e serbëve ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me marrëveshjen më të fundit të arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe aneksin e implementin të arritur në Ohër. Sidoqoftë, një numër i rëndësishëm i shqiptarëve (43%) dhe serbëve (33%) janë përgjigjur se nuk di/nuk kam mendim për këtë çështje.

Pastaj, ne veçanërisht u përqendruam në çështjen e **dhënies eventuale të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare**. Shumica e respondentëve, **50%**, u përgjigjën me 'fuqimisht nuk pajtohem' ose 'nuk pajtohem' me këtë deklaratë. Në mesin e shqiptarëve ekziston një mbështetje e vogël (**13%**), por në mesin e serbeve një mbështetje e rëndësishme (**46%**) për dhënien e kompetencave ekzekutive për asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në këmbim të anëtarësimit të Kosovës në disa organizata ndërkombëtare. Një numër i rëndësishëm i respondentëve shqiptarë (34%) dhe serbë (35%) janë përgjigjur me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Më poshtë paraqesim arsyet që respondentët janë **pajtuar me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe**:

- Do të përmirësojë prosperitetin ekonomik të Kosovës në 3-5 vitet e ardhshme (76% e shqiptarëve përkundrejt 45% të mostrës serbe);
- Do t'u japë serbëve që jetojnë në Kosovë më shumë zë në procesin e vendimmarrjes (64% e shqiptarëve përkundrejt 98% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë integrimin e komunitetit serb në Kosovë (69% e shqiptarëve përkundrejt 98% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë marrëdhëniet me Serbinë (53% e shqiptarëve përkundrejt 91% të mostrës serbe).

Më poshtë shpërfaqen arsyet që respondentët **nuk janë pajtuar me dhënien e kompetencave për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe**:

- Do të thellojë ndarjet ndërmjet komuniteteve në Kosovë (65% e shqiptarëve përkundrejt 26% të mostrës serbe);

- Do të rrisë tensionet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (70% e shqiptarëve përkundrejt 79% të mostrës serbe);
- Do të hap derën për krijimin e një mini Republika Srpska në Kosovë (72% e shqiptarëve përkundrejt 16% të mostrës serbe);
- Do ta vështirësojë arritjen e prosperitetit ekonomik për Kosovën në 3-5 vitet e ardhshme (63% e shqiptarëve përkundrejt 26% të mostrës serbe).

Grupi i tretë i gjetjeve ka të bëjë me perceptimin e qytetarëve të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës, me përqendrim të veçantë në përfaqësimin e gruas në këtë ekip. Në lidhje me këtë, sondazhi ka shtruar pyetje për (a) përfaqësimin e ekipit të dialogut vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë (d.m.th., kryeministri dhe zëvendëskryeministri); (b) nëse qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë (p.sh., përfaqësues nga partitë politike opozitare, shoqëria civile, akademia, etj.) dhe veçanërisht (c) gra si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog; dhe (d) nëse qytetarët e Kosovës mbështesin emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Sa i përket **pikës së parë, që është përfaqësimi i ekipit të dialogut vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë (d.m.th., kryeministri dhe zëvendëskryeministri) – 46%** nga mostra e përgjithshme janë përgjigjur me 'fuqimisht nuk pajtohem' ose 'nuk pajtohem' me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë. **34%** nga respondentët shqiptarë dhe **37%** serbë janë përgjigjur me 'fuqimisht pajtohem' ose 'pajtohem' për përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë. Një numër i rëndësishëm nga shqiptarët (20%) dhe nga serbët (18) janë përgjigjur me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje.

Sa i përket **pikës së dytë, që është nëse qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë (p.sh., përfaqësues nga partitë politike opozitare, shoqëria civile, akademia, etj.) – 66%** nga mostra e përgjithshme janë përgjigjur me 'patjetër që duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje të përfshij përfaqësues tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. **18%** e shqiptarëve dhe **29%** e

serbëve janë përgjigjur se qeveria e Kosovës 'padyshim që nuk duhet' ose 'nuk duhet' të bëjë përpjekje të përfshij përfaqësues tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. Më poshtë janë rezultatet për arsyet me të cilat respondentet janë ***pajtuar se qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë:***

- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë do ta bënte Dialogun më të hapur dhe transparent (87% e shqiptarëve përkundrejt 95% të mostrës serbe);
- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë do t'i bënte takimet e dialogut më efektive në lidhje me arritjen e marrëveshjeve (85% e shqiptarëve përkundrejt 96% të mostrës serbe);
- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë do t'a ngriste pronësinë/përgjegjësinë vendore në lidhje me marrëveshjet (78% e shqiptarëve përkundrejt 91% të mostrës serbe);
- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë do të bënte zbatimin e marrëveshjeve më të mundshme (77% e shqiptarëve përkundrejt 76% të mostrës serbe).

Më poshtë janë rezultatet rreth arsyeve me të cilat respondentët ***nuk janë pajtuar se qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë:***

- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë në Dialog do ta bënte të pamundur koordinimin efektiv në Dialog (56% e shqiptarëve përkundrejt 62% të mostrës serbe);
- Përfshirja e përfaqësuesve tjerë do t'i bënte takimet e dialogut më pak efektive në lidhje me arritjen e marrëveshjeve (54% e shqiptarëve përkundrejt 72% të mostrës serbe);
- Vetëm përfaqësuesit qeveritarë duhet të kenë përgjegjësinë për procesin e dialogut (65% e shqiptarëve përkundrejt 79% të mostrës serbe);
- Ndërmjetësuesit e Bashkimit Evropian nuk lejojnë hapësirë që shumë përfaqësues të marrin pjesë në procesin e dialogut (39% e shqiptarëve përkundrejt 38% të mostrës serbe).

Pika e tretë është nëse qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave në Dialog si përfaqësuese/ndërtuese të paqes – 82% nga mostra e përgjithshme janë përgjigjur me 'patjetër që duhet' ose 'ndoshta duhet'

të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave në dialog si përfaqësuese/ndërtuese të paqes. **8%** nga shqiptarët dhe **36%** nga serbët janë përgjigjur se qeveria e Kosovës 'padyshim që nuk duhet' ose 'nuk duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave në dialog si përfaqësuese/ndërtuese të paqes.

Sa i përket pikës së katërt, nëse qeveria e Kosovës duhet të emëroj një grua për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë – **82%** nga mostra e përgjithshme janë përgjigjur me mbështetje 'tepër shumë' ose 'deri diku' në emërim të një gruaje në udhëheqje të procesit të dialogut. **7%** nga shqiptarët dhe **32%** nga serbët janë përgjigjur me mbështetje 'shumë pak' ose 'aspak' në përcaktim të një gruaje në udhëheqje të procesit të dialogut.

Grupi i katërt dhe i fundit i gjetjeve lidhet me pengesat e mundshme me të cilat gratë ballafaqohen për pjesëmarrje në procesin e dialogut. Respondentët janë ekspozuar një numri të deklaratave për pengesat e mundshme, dhe më poshtë paraqesim përgjigjet 'fuqimisht pajtohem' ose 'pajtohem' nga mostra e përgjithshme:

- Gratë nuk janë të përfaqësuara në Dialog sepse përfaqësuesit kryesorë politikë dominohen nga burrat (**63%**);
- Gratë nuk janë të përfaqësuara në Dialog sepse qeverisë i mungon strategjia për të mbështetur angazhimin e grave në Dialog (**61%**);
- Grave u mungon motivimi për t'u angazhuar në procesin e dialogut (**41%**);
- Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset e vendimmarrjes (**38%**);
- Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirje gjinore në procesin e dialogut (**37%**);
- Për gratë është e vështirë përkushtimi në Dialog (**28%**);
- Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë (**16%**).

Rezultatet kanë treguar se ekzistojnë dallime gjinore në deklaratimet (a) **Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë** (ky perceptim ishte më i shpeshtë në mesin e burrave sesa grave); (b) **Shoqëria në Kosovë i**

përrjashton gratë nga të gjitha proceset e vendimmarrjes (ky perceptim ishte më i shpeshtë në mesin e grave se burrave); dhe (c) ***Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirje gjinore në procesin e dialogut*** (ky perceptim ishte më i zakonshëm në mesin e grave sesa burrave).

Në pika të shkurtra, pikëpamjet e dy komuniteteve ngjasojnë dhe dallojnë në disa aspekte. Respondentët shqiptarë dhe serbë janë të pakënaqur me marrëveshjen me të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Respondentët shqiptarë dhe serbë mbështesin përfshirjen e përfaqësuesve tjerë, veçanërisht të grave në ekipin e dialogut të Kosovës. Sidoqoftë, shqiptarët dhe serbët, ndryshojnë rrënjësisht sa i përket dhënies së kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Respondentët serbë janë të shqetësuar për tensionet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, derisa respondentët shqiptarë të brengosur për rreziqet e krijimit të një mini Republika Srpska. Përgjigjet nga respondentët tonë sugjerojnë që Dialogu nuk duhet të jetë një lojë 'zero-sum' ku përfitimi për njërin palë nënkupton humbje për palën tjetër.

1. Hyrje

Sondazhi, *Zëri i Popullit* rreth 'Shtegut të Paqes' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: *Shpalosja e Rolit të Grave*, është zbatuar në periudhën kohore nga data 27 maj deri më 3 qershor 2024. Sondazhi kishte tre qëllime të përgjithshme. Qëllimi i *parë* i sondazhit ishte të kuptoj perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me procesin aktual të dialogut dhe marrëveshjen më të fundit të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shkurt, 2023) dhe aneksin e saj të zbatimit të arritur në Ohër (mars, 2023). Qëllimi i *dytë* i sondazhit ishte të kuptoj perceptimin e qytetarëve të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës dhe mbështetjen ose mungesën e mbështetjes për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë, me përqendrim të veçantë në përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në ekipin e dialogut. Qëllimi i *tretë* ishte të kuptojmë faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut. Vlen të theksohet fakti se ky sondazh bazohet në gjetjet e një studimi të përbashkët të publikuar në prill 2024 nga RIDEA dhe Inclusive Peace 'Formësimi i Paqes: Përfshirja e Grave në Procesin e Paqes Kosovë-Serbi'. Të gjeturat nga intervistat e strukturuar të mbajtura për këtë studim nga RIDEA dhe Inclusive Peace, shkurtimisht, treguan natyrën përjashtuese të procesit të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht sfidat kryesore për përfshirjen e grave. Bazuar në këtë, sondazhi ka përpiluar pyetje kryesisht të tipit të mbyllur me qëllim që të kuptoj opinionin e qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, rolin e grave në këtë proces dhe pengesat me të cilat gratë ballafaqohen në përfshirjen në procesin e dialogut.

Kosova ka shpallur pavarësinë me 17 shkurt 2008, veprim ky që nuk njihet nga Serbia. Më 9 shtator 2010, Asambleja e Përgjithshme e KB ka miratuar rezolutën Nr. 64/298 me aklamacion. Kjo rezolutë njohu përmbajtjen e opinionit këshillues të GjND-së sa i përket deklaratës së pavarësisë së Kosovës dhe ka mirëpritur gatishmërinë e Bashkimit Evropian (BE) për lehtësimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Takimi i parë i dialogut lehtësuar nga BE-ja është mbajtur më 8 mars 2011. Që atëherë, Dialogu është zhvilluar në dy nivele: (i) Dialogu

teknik dhe (ii) Dialogu politik. Ndërmjet 2011 dhe 2022, shumë marrëveshje janë arritur, edhe pse me batica dhe zbatim, dhe disa herë, procesi i dialogut është ndërprerë për muaj të tërë. Bisedimet në vazhdimësi për normalizim ndërmjet dy shteteve, lehtësuar nga aktorët ndërkombëtarë, kanë për qëllim vendosjen e një mirëkuptimi reciprok dhe bashkëpunimi, përderisa adresohen çështjet lidhur me qeverisjen, sigurinë, dhe zhvillimin ekonomik. Derisa është arritur një progres sa i përket lëvizjes së lirë, menaxhimit të kufijve, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe religjionit, dhe integrimin e policëve, shumë marrëveshje të tjera nuk janë zbatuar ose janë zbatuar vetëm pjesërisht nga të dy vendet.¹

Për shkak të ndryshimeve gjeopolitike pas invazionit rus në Ukrainë në shkurt 2022, Franca dhe Gjermania filluan një iniciativë urgjente në shtator 2022, ku prezantuan një plan konkret për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve dhe si pasojë zbutjen e tensioneve në veri të Kosovës, që mund të gjeneronte tensione shtesë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo iniciativë më pas u njoh si një përpjekje e përbashkët e BE-së me mbështetje të Shteteve të Bashkuara. Diplomacia e re 'fluturuese' filloi duke përfshirë udhëtime të shpeshta në Kosovë dhe Serbi nga të dërguar special nga BE, SHBA, Franca, Gjermania, dhe Italia, me takime përcjellëse në Bruksel ndërmjet delegacioneve nga Kosova dhe Serbia. Rrjedhimisht, në muajin shkurt 2023, nxitur nga BE dhe SHBA, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për rrugën e normalizimit. Më vonë, më 18 mars 2023, në Ohër (Maqedonia e Veriut), Kosova dhe Serbia arritën që Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve t'ja bashkangjesin Aneksin e Implementimit.

Në fakt, procesi i normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk është i izoluar nga konteksti më i gjerë i procesit të paqes. Së pari, procesi i paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë konsiderohet të jetë i stagnuar, me palët e interesuara politike që perceptojnë atë si një platformë për kompromise të panevojshme ose një lojë 'zero-sum'. Të tjerët shprehin brengën në lidhje me përkushtimin e

¹ Komisioni Evropian (2013) 'Serbia dhe Kosova*: marrëveshja historike shtron rrugën për progres vendimtar sa i përket perspektivës në BE', Deklaratë Shtypi, 22 prill. E disponueshme në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-347_en.htm (Qasur më: 11/06/2024).

brendshëm të dobët dhe zvogëlimin e rëndësisë së BE-së, që nxiste përpjekjet në dialog për të avancuar proceset dhe ndërtimin e paqes për të adresuar negociatat stagnuese dhe deficitet në zbatim².

Ky sfond dhe kontekst i shkurtër gjithashtu shfaqin dhe disa çështje që janë adresuar në këtë sondazh dhe të cilat prezantohen në seksionet vijuese të këtij studimi.

2. Metodologjia

2.1. Dizajni i Sondazhit

Pyetësi i këtij sondazhi përbëhet nga pyetjet e mbyllura me strukturën vijuese: të dhëna demografike për pjesëmarrësit, perceptimin e tyre, qëndrimin dhe mbështetjen, ose mungesën e mbështetjes për procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës me përqendrim të veçantë në përfaqësimin e grave, dhe pengesat për pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut. Pyetësi përmban edhe ca pyetje të hapura që qytetarët të mund t'i shprehin mendimet e tyre alternative. Dy hulumtues të pavarur vlerësuan pyetësin sa i përket kuptimit dhe qartësisë së pyetjeve.

2.2. Procedura e Sondazhit

Ekipi hulumtues përbëhej nga 13 intervistues në terren (plus 2 intervistues special për të anketuarit serbë në Kosovë), 3 hulumtues të lartë/ekspertë, dhe 2 asistentë hulumtues dhe administrativ. Puna e tyre rezultoi në raportin/studimin aktual hulumtues. Intervistuesit në terren i administruan pyetësit me tabletë elektronike duke përdorur softuerin e dizajnuar posaçërisht për këtë sondazh. Pyetësi u plotësua nga intervistuesit në terren për të siguruar që nuk kishte mungesë të të dhënave. Megjithatë, të anketuarit ishin të lirë të mos i përgjigjeshin pyetjeve. Për të shmangur njëanshmërinë në intervistë, ekipi hulumtues i trajnoi të gjithë intervistuesit e terrenit, për zbatimin e sondazhit.


² RIDEA dhe Inclusive Peace (2024). 'Formësimi i Paqes: Përfshirja e Grave në Procesin e Paqes ndërmjet Kosovës-Serbisë'. E disponueshme: <https://www.ridea-ks.org/uploads/ShapingPeace.pdf> (Qasur më: 11/06/2024).

Për të kontrolluar punën e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, rreth 15% (gjithsej 167 të anketuar) u ri-intervistuan. Ky kontroll është bërë kryesisht përmes intervistave telefonike dhe ca vizitave në terren. Si kontroll, të anketuarit u pyetën për rreth 5 pyetje bazuar në intervistën origjinale. Lista e kontrollit shërbeu si një mjet për rishikimin e pajtueshmërisë me parimin e përzgjedhjes së rastësishme të të anketuarve (që mbulojnë përzgjedhjen e lokalitetit, pikën fillestare, njësinë e shtëpisë dhe përzgjedhjen e të anketuarit). Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të kontrollit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar.

2.3. Mostra

Sondazhi u zbatua në 38 komuna të 7 rajoneve kryesore të Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë (Veri dhe Jug, shih hartën më poshtë). Kosova ka një popullsi prej 1,798,506 banorë³. Në këtë sondazh, për secilën komunë është përdorur mostra e thjeshtë proporcionale, bazuar në madhësinë e popullsisë së komunës, që është në raport me numrin e popullsisë së regjistruar në një komunë specifike me numrin e përgjithshëm të banorëve të regjistruar në Kosovë. Përqindja që rezulton përcakton peshën e secilës komunë në mostër. Baza e popullsisë së regjistruar është nxjerrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021) "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021". E disponueshme në: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/4bd04f76-1e2b-444c-8dc1-86d3edf20225.pdf> (Qasur më: 05/06/2024).




Pyetësorët u administruan në shtëpitë dhe banesat e të anketuarve. Për të përcaktuar mostrën e studimit është përdorur procedura e mostrës së rastësishme, me rregullat e përcaktuara për zgjedhjen e pikës fillestare, dhe përzgjedhjen pasuese të rrugës, ndërtesës, banesës dhe respondentit. Pyetësori u administrua vetëm tek një anëtar i familjes. Kjo është bërë në këtë mënyrë për të shmangur njëanshmërinë e mostrës.

Për të pasur një mostër mjaftueshëm të madhe të serbëve për analiza më të dobishme, mostra është dyfishuar në dy komunat kryesore serbe, Mitrovicë Veriore (në veri të Kosovës) dhe Graçanicë (në jug të Kosovës). Kjo dha një mostër prej 100 respondentëve serbë në vend të 50 të anketuarve që do të ishin marrë po mos të dyfishonim numrin e mostrës.

2.4. Karakteristikat e Mostrës

Numri i përgjithshëm i të anketuarve për këtë sondazh është 1108. Me një mostër të kësaj madhësie, kufiri i gabimit në vlerësim është plus ose minus 3 pikë përqindje (në nivel të rëndësisë 5 përqind). Vini re që, kufiri i gabimit është më i vogël kur vlerësimet janë vetëm për mostrën serbe prej 100 të anketuarve: me një mostër prej 100, kufiri i gabimit prej 95% do të jetë përafërsisht plus ose minus 1 pikë përqindjeje. Rrjedhimisht, të gjitha dallimet ndërmjet mostrave serbe dhe shqiptare janë kontrolluar për rëndësi statistikore.

Siç është thënë më lart, studimi është implementuar në të gjitha (shtatë) rajonet e Kosovës dhe (tridhjetë e tetë) komunat. Më poshtë paraqesim shpërndarjen e mostrës në shtatë rajonet.



Numri i intervistave për secilën komunë është caktuar në bazë të numrit të popullsisë në secilën komunë dhe shpërndarja e mostrës së arritur kështu korrespondon ngushtë me shpërndarjen e popullsisë. Shih mëposhtë tabelën që përshkruan numrin e popullsisë bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës⁴ dhe numrin e intervistave të realizuara nëpër komuna.


⁴Po aty.

ZËRI I POPULLIT RRETH 'SHTEGUT TË PAQES' NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBIË:
SHPALOSJA E ROLIT TË GRAVE

Tabela 1. Madhësia e popullsisë dhe numri i intervistave për komunë			
Nr	Komuna	Popullsia	Nr. i të intervistuarve
1	<i>Ferizaj</i>	<i>103,003</i>	<i>63</i>
2	<i>Shtime</i>	<i>27,654</i>	<i>35</i>
3	<i>Kaçanik</i>	<i>33,409</i>	<i>20</i>
4	<i>Shtërpcë</i>	<i>6,773</i>	<i>8</i>
5	<i>Hani i Elezit</i>	<i>9,998</i>	<i>6</i>
6	<i>Gjakovë</i>	<i>95,340</i>	<i>58</i>
7	<i>Rahovec</i>	<i>59,102</i>	<i>36</i>
8	<i>Deçan</i>	<i>41,808</i>	<i>26</i>
9	<i>Junik</i>	<i>6,370</i>	<i>4</i>
10	<i>Gjilan</i>	<i>80,162</i>	<i>48</i>
11	<i>Kamenica</i>	<i>30,750</i>	<i>19</i>
12	<i>Viti</i>	<i>47,615</i>	<i>29</i>
13	<i>Ranillug</i>	<i>3,810</i>	<i>3</i>
14	<i>Novobërdë</i>	<i>7,160</i>	<i>5</i>
15	<i>Partesh</i>	<i>1730</i>	<i>2</i>
16	<i>Klllokot</i>	<i>2,753</i>	<i>2</i>
17	<i>Mitrovicë</i>	<i>69,346</i>	<i>44</i>
18	<i>Vushtrri</i>	<i>64,468</i>	<i>39</i>
19	<i>Mitrovica Veriore</i>	<i>12,211</i>	<i>40</i>
20	<i>Zveçan</i>	<i>7,376</i>	<i>5</i>
21	<i>Zubin Potok</i>	<i>6,616</i>	<i>5</i>
22	<i>Leposaviq</i>	<i>13,587</i>	<i>8</i>
23	<i>Skenderaj</i>	<i>52,343</i>	<i>32</i>
24	<i>Pejë</i>	<i>99,568</i>	<i>61</i>
25	<i>Istog</i>	<i>40,380</i>	<i>11</i>
26	<i>Klin</i>	<i>40,122</i>	<i>12</i>
27	<i>Prishtinë</i>	<i>211,755</i>	<i>131</i>
28	<i>Obiliq</i>	<i>19,144</i>	<i>12</i>
29	<i>Fushë Kosovë</i>	<i>38,607</i>	<i>24</i>
30	<i>Lipjan</i>	<i>57,733</i>	<i>35</i>
31	<i>Podujevë</i>	<i>83,445</i>	<i>51</i>
32	<i>Glllogoc</i>	<i>61,133</i>	<i>19</i>
33	<i>Graçanicë</i>	<i>12,091</i>	<i>20</i>
34	<i>Prizren</i>	<i>191,565</i>	<i>112</i>
35	<i>Suharekë</i>	<i>60,247</i>	<i>21</i>
36	<i>Malishevë</i>	<i>58,269</i>	<i>37</i>
37	<i>Mamushë</i>	<i>5,950</i>	<i>4</i>
38	<i>Dragash</i>	<i>34,316</i>	<i>21</i>
	Total	1,798,506	1108

89% e mostrës së studimit ishin shqiptarë, 9% serb dhe 2% ishin nga grupe tjera etnike në Kosovë. Përqindja shqiptare e mostrës korrespondon ngushtë me regjistrimin e vitit 2011, gjë që tregon se 91% ishin shqiptarë, 3.4% serbë dhe 5.6% 'të tjerë'. Sikurse është përmendur në Seksionin 2.3 dhe si demonstrojnë përqindjet, ne kemi dyfishuar mostrën serbe për të siguruar një numër të mjaftueshëm të respondentëve për analiza gjithëpërfshirëse. Numri i vogël i grupeve etnike 'të tjera' është shumë i vogël për analiza të dobishme dhe nuk ofron një bazë të besueshme për ta matur/peshuar.

43.2% e mostrës së studimit janë meshkuj dhe 56.8% janë femra. Moshë mesatare e mostrës është 43 vjeç, dhe rangi i moshës është 18-93 vjeç. Më poshtë paraqesim shpërndarjen e mostrës sipas grupmoshës.



Krahasuar me të dhënat e regjistrimit më 2011, gratë dhe të rinjtë janë të mbipërfaqësuar në mostrën tonë. Për më shumë, moshë dhe edukimi nuk janë ngushtë të ndërlidhura me variablat e paraqitura në këtë raport. Prandaj, ne, raportojmë për qindjet e papeshuara.

Sa i përket nivelit të arsimimit, 2% e mostrës ka deklaruar se nuk kanë diplomë shkollë, 3% kanë deklaruar vetëm arsim fillor (1-5 klasë), 15% kanë deklaruar arsim të mesëm të ulët (6-9 klasë), 31% shkollë të mesme të lartë (gjimnaz ose

shkollë profesionale), 3% arsim profesional pas shkollës së mesme, 31% kanë deklaruar se kanë diplomë universitare (Bachelor), 5% me Master dhe ca me doktoraturë. Sikurse zakonisht ndodh me sondazhe, vihet re një mbipërfaqësim i atyre me shkollim të lartë.

Sa i përket nivelit të punësimit të mostrës sonë, 52% raportuan të jenë punësuar në kohën e intervistës, 23% të papunë, 7% studentë, 10% në pension, 6% që përmbushin detyrat e shtëpisë, dhe 2% të papërcaktuar. Lidhur me kategoritë e punësimit, 31% raportuan të jenë në pozita profesionale ose teknike (të tilla si: mjek, mësues, inxhinier, artist, kontabilist, etj.), 3% pozita të larta administrative (të tilla si: bankier, drejtues në biznese të mëdha, zyrtarë qeveritarë, etj.), 4% pozita të sekretarisë (të tilla si: sekretar, menaxher i zyrës, mbajtës i librave, etj.), 5% pozita të shitjes/shërbimit (të tilla si: menaxher i shitjes, pronar dyqani, etj.), 6% punëtor të kualifikuar (të tilla si: auto-mekanik, elektrikist, etj.), 2% punëtor gjysmë të kualifikuar (të tilla si: vozitës autobusi, zdrukthtar, etj.), 1% punëtor të pakualifikuar (të tilla si: punëtor krahu, roje, etj.), 1% punëtor të fermës (të tilla si: fermer, punëtor krahu i fermës, etj.), 7% studentë, 19% amvise, dhe 16% të paspecifikuar.

2.5. Analiza e të dhënave

Përgjigjet e pjesëmarrësve u futën në SPSS. Statistikat përshkruese, të tilla si frekuencat dhe kros-tabulimet në bazë të grupeve etnike, janë përdorur për të analizuar të dhënat. Ne gjithashtu kemi kontrolluar nëse rezultatet ndryshojnë sipas moshës, gjinisë, dhe nivelit arsimor.

3. Gjetjet


Kjo pjesë përshkruan gjetjet e këtij sondazhi në katër nën-kategori: **(i)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (përfshirë arsyt kryesore për mbështetjen ose mungesën e saj për procesin e dialogut) dhe mbështetjen për procesin e dialogut në formatin aktual; **(ii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëveshjen më të fundit të

Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shkurt, 2023) dhe aneksin saj të zbatimit të Ohrit (mars, 2023), duke përfshirë arsyet kryesore për mbështetjen ose mungesën e saj; **(iii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës me fokus të veçantë në përfaqësimin e grave në këtë ekip (duke përfshirë arsyet kryesore për mbështetjen ose mungesën e saj); dhe **(iv)** faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut.


3.1. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Sa i përket kësaj, pyetja vijuese është shtruar: **Sa jeni të kënaqur me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**


Gjetjet në lidhje me këtë tregojnë me këtë çështje shpërfaqin peisazhin vijues: Pothuajse gjysma e mostrës, 49% nga totali, nuk ishin të kënaqur me procesin e dialogut (17% deklaruan se janë 'shumë të pakënaqur' dhe 32% 'të pakënaqur'). Rreth 26% e respondentëve deklaruan se (3% deklaruan 'shumë të kënaqur' dhe 23% 'të kënaqur') janë të kënaqur me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 25% e pjesëmarrësve u deklaruan me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Prandaj, ekziston një pakënaqësi evidente mes qytetarëve të Kosovës në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.



Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve: 46% e shqiptarëve dhe 80% e serbëve janë 'shumë të pakënaqur' ose 'të pakënaqur' në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 28% në mesin e shqiptarëve dhe 3% në mesin e serbëve janë 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' në lidhje me procesin aktual të dialogut. 26% në mesin e shqiptarëve dhe 17% e serbëve u deklaruan me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Këto ndryshime janë statistikisht të rëndësishme (së paku në nivelin 0.05) por në përgjithësi janë në linjë me idenë që qytetarët nuk janë të kënaqur me procesin aktual të dialogut.




Pastaj, janë shtruar një numër pyetjesh pasuese në lidhje me arsyet kryesore pse respondentët ishin ose nuk ishin të kënaqur me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Respondentët që u përgjigjën se ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u përgjigjën si vijon (shih grafikonin më poshtë) në lidhje me arsyet kryesore se pse ishin të kënaqur me procesin aktual të dialogut (vetëm 29% e mostrës shqiptare dhe 3% e serbe ishin të kënaqur, prandaj janë ekspozuar ndaj pyetjeve plotësuese/vijuese, ashtu që përgjigjet bazohen në një numër mjaft të vogël, sidomos në mostrën serbe)



Siç shihet, respondentët shqiptarë kishin më shumë gjasa të deklarojnë që procesi aktual i dialogut së paku garanton paqe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pasuar me raportet e mira pune me BE-në dhe OKB-në. Respondentët serbë kishin më shumë gjasa, por njëjtë, të deklarojnë që procesi aktual i dialogut së paku pengon dëbimin e serbëve nga Kosova dhe mban hapur derën për një ndikim të fortë serb në Kosovë. Kur është kërkuar nga respondentët që të kategorizojnë se cilat nga arsyet e mësipërme është më e rëndësishme për të qenë i kënaqur me dialogun, shqiptarët (46%) dhe serbët (67%) më së shpeshti deklaruan se procesi i dialogut së paku garanton paqe.


Tani, vazhdojmë me respondentët që ishin 'shumë të pakënaqur' ose 'të pakënaqur' me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një numër i deklaratave të formuluar ndryshe dhe paralelisht me pyetje plotësuese/vijuese janë shtruar. Gati gjysma e shqiptarëve (46%) dhe shumica serbe (80%) janë ekspozuar pyetjeve vijuese:




Sic mund të shihet, respondentët shqiptarë më së shumti deklaruan mungesën e njohjes nga Serbia, ndjekur nga mungesa e marrëdhënieve paqësore me Serbinë ose njohjes së globale në rrethanat aktuale. Respondentët serbë, sidoqoftë, më së shumti deklaruan se problemet e brendshme nuk mund të zgjidhen në rrethanat aktuale, ndjekur nga një distancë e konsiderueshme rreth mungesës së njohjes nga Serbia (të gjitha deklaratimet tjera ishin të afër). Kur respondentëve iu është kërkuar të kategorizonin se cila nga arsyet e mësipërme është më e rëndësishmja se pse nuk jeni të kënaqur me dialogun, respondentët shqiptarë më së shumti deklaruan mungesën e njohjes nga Serbia (22.1%). Për dallim, respondentët serbë më së shumti deklaruan problemet e brendshme ndërmjet komuniteteve serbe dhe shqiptare (46%).

Në lidhje me perceptimin për procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pyetja vijuese/pasuese është shtruar: **A do ta mbështesnit vazhdimin e Dialogut në formatin aktual për pesë vitet e ardhshme?**

32.4% e mostrës së përgjithshme treguan se 'aspak' ose 'shumë pak' do të mbështesnin vazhdimin e Dialogut në formatin aktual për pesë vitet e ardhshme. 44.6% treguar mbështetje 'deri diku' ose 'tepër shumë' për vazhdimin e Dialogut në formatin aktual. 23% u përgjigjën me nuk di/nuk kam mendim për këtë çështje.



Vlerësimi i përgjigjeve të mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ngjashëm të përgjigjeve. 32% e shqiptarëve dhe 44% e serbëve treguan se 'aspak' ose 'shumë pak' mbështetje për vazhdimin e Dialogut në formatin aktual për pesë vitet e ardhshme. 44% në mesin e shqiptarëve dhe 42% në mesin e serbëve treguan 'deri diku' ose 'tepër shumë' mbështetje për vazhdimin e Dialogut në formatin aktual (shih grafikun më poshtë). 24% mes shqiptarëve dhe 14% dhe në mesin e serbëve, respektivisht, u përgjigjën me nuk di/nuk kam mendim për këtë çështje.



3.2. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë


Sa i përket marrëveshjeve, sondazhi u përqëndrua në marrëveshjen me të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit mes Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, brenda këtij seksioni sondazhi ka trajtuar dhe çështjen e dhënies së kompetencave ekzekutive të zgjeruara për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare.

3.2.1. Mbështetja për marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit


Lidhur më pyetjen për marrëveshjet mes Kosovës dhe Serbisë, sondazhi parashtrroi këtë pyetje: **Sa jeni të kënaqur me marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nën lehtësimin e BE-së?**⁵ 14.9% nga të gjithë respondentët ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nën lehtësimin e

⁵ Respondentëve iu është ofruar shpjegim shtesë në lidhje me këtë pyetje: Disa nga pikat kritike të marrëveshjes përfshijnë: njohjen reciproke të dokumenteve dhe simboleve respektive kombëtare, themelimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, zyrtarizimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, dhe anëtarësimin eventual të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

BE-së. Pjesa më e madhe e respondentëve (43%) ishin 'të pakënaqur' ose 'aspak të kënaqur' me marrëveshjen më të fundit të Brukselit. Një numër i madh i pjesëmarrësve (41.8%) u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje.




Vlerësimi i përgjigjeve ndarazi për respondentët shqiptarë dhe serbë tregon disi një model të ngjashëm. 16% në mesin e shqiptarëve dhe 6% në mesin e respondentëve serbë ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 43% në mesin e shqiptarëve dhe 61% në mesin e respondentëve serbë ishin 'të pakënaqur' ose 'aspak të kënaqur' me marrëveshjen më të fundit të Brukselit. 43% dhe 33% e respondentëve shqiptarë dhe serbë, respektivisht, u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Këto rezultate tregojnë se respondentët serbë kanë një perceptim më homogjen në lidhje me marrëveshjen më të fundit krahasuar me atë shqiptarë.




3.2.2. Mbështetja për kompetencat e zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe

Në lidhje me perceptimet e qytetarëve për marrëveshjen më të fundit të Brukselit, sondazhi u përqendrua edhe në çështjen e ndërlidhur me dhënien eventuale të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Pyetja vijuese është shtruar në sondazh: **A pajtoheni me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje në disa organizata ndërkombëtare?**⁶ 15.7% nga mostra e përgjithshme 'fuqimisht pajtohen' ose 'pajtohen' në lidhje me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje/anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare. Gjysma e respondentëve (50.1%), megjithatë, 'nuk pajtohen' ose 'fuqimisht nuk pajtohen' lidhur me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje/anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare. 34.2% u përgjigjën se 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje.


⁶ Për të qartësuar këtë pyetje, është ofruar shpjegim vijues: Me kompetenca të zgjeruara ekzekutive nënkuptojmë kompetenca që përfshijnë ndryshime kushtetuese dhe do të krijonin një entitet të ri politik në Kosovë, rrjedhimisht një entitet gjysmë autonom.



Analiza e përgjigjeve të mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model të kundërt në lidhje me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje në disa organizata ndërkombëtare. 13% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 46% në mesin e serbëve 'fuqimisht pajtohen' ose 'pajtohen' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje në disa organizata ndërkombëtare. 53% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 19% në mesin e serbëve 'nuk pajtohen' ose 'fuqimisht nuk pajtohen' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje në disa organizata ndërkombëtare. 34% në mesin e shqiptarëve dhe 35% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Këto rezultate tregojnë një dallim sa i për mbështetjes për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në mesin e shqiptarëve dhe serbëve.




Me një numër pyetjesh plotësuese/vijuese, sondazhi kishte për qëllim të kuptoj arsyet kryesore se pse respondentët pajtohen ose jo lidhur me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje/anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare. Respondentët që u përgjigjën se 'fuqimisht pajtohen' ose 'pajtohen' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, pyetjet vijuese iu janë parashtruar (13% e shqiptarëve dhe 46% e serbëve iu janë ekspozuar këtyre pyetjeve):



Për respondentët shqiptarë që u janë përgjigjur këtyre pyetjeve vijuese, arsyeja më e shpeshtë e dhënë ishte prosperiteti ekonomik për Kosovën, ndjekur nga përmirësimi i integritetit të komunitetit serb në Kosovë dhe se serbët do të kishin më shumë zë në vendimmarrje. Në mesin e respondentëve serbë, arsyeja më e shpeshtë e dhënë ishte integrimi i komunitetit serbë në Kosovë dhe se serbët do të kishin më shumë zë në vendimmarrje, ndjekur afër nga përmirësimi i marrëdhënieve me Serbinë. Këto arsye, në mesin e serbëve, ishin shumë më të shpeshta krahasuar me deklaratën alternative për prosperitetin ekonomik në Kosovë. Kur respondentëve u është kërkuar të kategorizojnë se cila nga arsyet e mësipërme është më e rëndësishmja për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive, respondentët shqiptarë më së shpeshti deklaruan prosperitetin ekonomik (55%), ndërsa respondentët serbë më së shpeshti deklaruan se kjo do t'i ofronte më shumë zë serbëve në procesin e vendimmarrjes (70%).

Ndaj respondentëve që u përgjigjën 'fuqimisht nuk pajtohen' ose 'nuk pajtohen' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe, një tjetër seri e pyetjeve plotësuese/vijuese u janë shtruar (53% e shqiptarëve dhe 19% e serbëve u janë ekspozuar pyetjeve vijuese):



Siç shihet, respondentët shqiptarë që ishin kundër dhënies së kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe pajtohen që kompetenca të tilla mund të hapin derë për krijimin e një mini Republika Srpska, ndjekur afër nga brenga për rritjen e tensioneve politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe thellimin e dallimeve mes komuniteteve në Kosovë. Në mesin e respondentëve serbë, arsyeja më e shpeshtë ishte që kompetenca të tilla mund të rrisin tensionet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ndjekur me një dallim të konsiderueshëm për thellimin e dallimeve mes komuniteteve në Kosovë dhe vështirësimin e prosperitetit ekonomik në Kosovë. Kur respondentëve iu është kërkuar të kategorizojnë arsyen më të rëndësishme për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive, respondentët shqiptarë më së shpeshti deklaruan se kjo mund të hap derë për krijimin e një mini Republika Srpska (40%), ndërsa respondentët serbë më së shumti deklaruan se kjo do të vështirësoj prosperitetin ekonomik (53%).

3.3. Mbështetja për përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës

Për të adresuar këtë, pjesëmarrësit iu janë ekspozuar një numri të opsioneve/alternativave në lidhje me përfaqësimin e ekipit: a) sa mbështesin përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë; b) a duhet të qeveria e Kosovës të bëjë përpjekje për të përfshirë përfaqësues të tjerë sikur partitë politike opozitare, shoqërinë civile, akademinë, etj, (arsyet kryesore për përfshirjen ose mospërfshirjen e përfaqësuesve tjerë); dhe c) nëse qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve gra në ekip. Në lidhje me pikën e fundit, sondazhi eksplori faktorët që pengojnë në pjesëmarrjen e grave në Dialog dhe sa mbështesin emërimin e një gruaje në udhëheqje të ekipit.


3.3.1. A duhet të ekipi i Kosovës të përfaqësohet vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë?

Në lidhje me këtë, respondentët janë ekspozuar pyetjeve vijuese: **Aktualisht, takimet e dialogut në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuara nga BE-ja përfaqësohen vetëm nga përfaqësues të qeverisë nga niveli më i**

lartë (d.m.th., kryeministri dhe zëvendëskryeministri). A pajtoheni që ekipi i Kosovës të përfaqësohet vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar? 34% nga mostra e përgjithshme 'fuqimisht pajtohen' ose 'pajtohen' në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar (shih grafikun mëposhtë). Pothuajse gjysma e pjesëmarrësve (46%), sidoqoftë, u përgjigjën se 'nuk pajtohen' ose 'fuqimisht nuk pajtohen' me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar. 20% u përgjigjën se nuk di/nuk kam mendim për këtë çështje.




Analiza ndarazi e mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model të ngjashëm të përgjigjeve. 37% nga mostra shqiptare dhe serbe 'fuqimisht pajtohen' ose 'pajtohen' në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar. 36% në mesin e shqiptarëve, krahasuar me 45% serbë, 'nuk pajtohen' ose 'fuqimisht nuk pajtohen' në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar (shih grafikun më poshtë). 20% në mesin e shqiptarëve dhe 18% në mesin e serbëve u përgjigjën se 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Këto rezultate tregojnë se qytetarët shqiptarë të Kosovës pothuajse në mënyrë të barabartë janë të ndarë në atë nëse ekipi i dialogut të Kosovës duhet të përfaqësohet vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritar krahasuar me qytetarët serb të Kosovës, të cilët janë në përgjithësi më të pakënaqur në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësuesit më të lartë.




3.3.2. A duhet që qeveria e Kosovës të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë në ekipin e dialogut?


Në lidhje me këtë, respondentët janë përgjigjur në pyetjen vijuese: **A mendoni se qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë (p.sh., përfaqësues nga partitë politike opozitare, shoqëria civile, akademia, etj.) në takimet e dialogut në Bruksel?** 66% e mostrës u përgjigjën me 'patjetër duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. 19% u përgjigjën me 'padyshim që nuk duhet' ose 'nuk duhet' të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. 15% u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje.



Analiza ndarazi e mostrave shqiptare dhe serbe tregon për një model të ngjashëm të përgjigjeve. 67% nga respondentët shqiptarë dhe 55% nga respondentët serbë mendojnë se qeveria e Kosovës 'patjetër duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. 18% nga respondentët shqiptarë dhe 29% nga respondentët serbë mendojnë se qeveria e Kosovës 'padyshim që nuk duhet' ose 'nuk duhet' të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë në takimet e dialogut në Bruksel (shiko grafikunin mëposhtë). 15% në mesin e shqiptarëve dhe 16% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë.




Me një numër të pyetjeve plotësuese/vijuese, sondazhi kërkoj të kuptoj arsyet kryesore se pse respondentët duhet ose nuk duhet që të bëjnë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë në takimet e dialogut në Bruksel. Respondentët që u përgjigjën se Kosova 'patjetër duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë në takimet e dialogut në Bruksel, pyetjet vijuese iu janë prezantuar (67% nga mostra shqiptare dhe 55% nga serbe janë ekspozuar në këto pyetje):



Në mesin e respondentëve shqiptarë që iu janë ekspozuar pyetjeve vijuese, arsyeja më e shpeshtë për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë kishte të bënte me hapjen dhe transparencën e dialogut, dhe se do të ishte më efektiv në lidhje me arritjen e marrëveshjeve. Respondentët serbë deklaruan për tri arsye pothuajse në frekuencë të barabartë, me përjashtim të asaj se përfshirja e përfaqësuesve tjerë do t'a bënte zbatimin e marrëveshjeve më të mundshme. Kur respondentëve iu është kërkuar të kategorizojnë si më të rëndësishme ndër arsyet e cekura më lartë, respondentët shqiptarë deklaruan aspektin e hapjes dhe transparencës së dialogut (45%), ndërsa respondentët serbë më së shpeshti deklaruan përgjegjësinë vendore në lidhje me marrëveshjet (35%).

Sa i përket respondentëve që janë përgjigjur se Kosova 'nuk duhet' ose 'padyshim që nuk duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë në takimet e dialogut në Bruksel (18% e mostrave shqiptare dhe 29% serbe iu janë ekspozuar këtyre pyetjeve):




Siç mund të shihet, respondentët shqiptarë që nuk mbështesnin përfshirjen e përfaqësuesve tjerë, arsyeja më e shpeshtë e deklaruar ishte se përfaqësuesit qeveritarë duhet të kenë përgjegjësinë për Dialog, ndjekur nga arsyeja se përfshirja e përfaqësuesve tjerë do ta bënte të pamundur koordinimin efektiv të Dialogut. Respondentët serbë më së shpeshti deklaruan arsyen se përfaqësuesit qeveritarë duhet të kenë përgjegjësinë për Dialog, ndjekur nga ajo se përfshirja e përfaqësuesve tjerë do ta bënte dialogun më pak efektiv në lidhje me arritjen e marrëveshjeve. Kur respondentëve iu është kërkuar të kategorizojnë ndër më të rëndësishme arsyet e përmendura më lartë për mospërfshirjen e përfaqësuesve tjerë, si shqiptarët (30%) ashtu edhe serbët (38%) më së shpeshti deklaruan për përgjegjësinë qeveritare në lidhje me procesin e dialogut.


3.4. Përfaqësimi i grave në ekipin e dialogut të Kosovës

Sa i përket kësaj pyetje, respondentët janë pyetur: Aktualisht, gratë si përfaqësuese/ndërtuese të paqes janë të nënpërfaqësuara (nuk ka asnjë grua në pozitë kryesore/udhëheqëse) në ekipin e dialogut të Kosovës lehtësuar nga BE-ja në Bruksel. **A mendoni se qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog?** 82.4% e respondentëve u përgjigjën se qeveria e Kosovës 'patjetër që duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog. Përkundër, vetëm 10.7% u përgjigjën se qeveria e Kosovës


'padyshim që nuk duhet' ose 'nuk duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog. 6.9% u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë.



Analiza ndarazi për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model të ngjashëm të përgjigjeve. 86% e shqiptarëve dhe 53% e serbëve u përgjigjën se qeveria e Kosovës 'patjetër që duhet' ose 'ndoshta duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog. 8% në mesin e shqiptarëve dhe 36% në mesin e serbëve u përgjigjën se qeveria e Kosovës 'nuk duhet' ose 'padyshim që nuk duhet' të bëjë përpjekje për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në Dialog. 7% e shqiptarëve dhe 11% e serbëve u përgjigjën se 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë. Këto rezultate tregojnë se në mesin e respondentëve shqiptarë ekziston një mbështetje e fuqishme për përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese e paqes në dialog. Për dallim, respondentët serbë në Kosovë duken më heterogjen, edhe pse shumica mbështetin përfshirjen e grave si përfaqësuese/ndërtuese të paqes në dialog.




Në lidhje me këtë, pjesëmarrësit iu janë ekspozuar pyetjes vijuese: **A do ta mbështesnit emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet qeverive të Kosovës dhe Serbisë?** 81.9% nga mostra e përgjithshme u përgjigjën me 'deri diku' ose 'tepër shumë' mbështetje për emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet qeverive të Kosovës dhe Serbisë. Përkundër, vetëm 9.3% e respondentëve treguan 'shumë pak' ose 'aspak' mbështetje për emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut. 8.8% u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje.



Vlerësimi ndarazi i mostrave shqiptare dhe serbe tregon një ndryshim por model të ngjashëm të përgjigjeve. 84% e shqiptarëve dhe 54% e serbëve u përgjigjën me 'deri diku' ose 'tepër shumë' mbështetje për emërimin e një gruaje për të

udhëhequr procesin e dialogut. 7% e shqiptarëve dhe 32% e serbëve u përgjigjën me 'aspak' ose 'shumë pak' mbështetje për emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut. 8% e shqiptarëve dhe 4% e serbëve u përgjigjën me 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Këto rezultate tregojnë që në mesin e respondentëve shqiptarë, ekziston një mbështetje e fuqishme për emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ndryshe, respondentët serbë në Kosovë duken me përgjigje më heterogjene, edhe pse shumica mbështetin emërimin e një gruaje për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.



3.5. Faktorët potencial si frenues të pjesëmarrjes së grave në procesin e dialogut

Shpalosja e pengesave të mundshme për pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut është kyçe për të kuptuar arsyet se pse gratë nuk përfaqësohen dhe nuk përfshihen në ekipin e dialogut në Kosovë. Në një studim të fundit bazuar në 43 intervista të strukturuar me aktorë politikë, shoqërisë civile, dhe aktorë ndërkombëtarë, RIDEA dhe Inclusive Peace identifikuan një numër të pengesave për pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut në Kosovë.⁷ Bazuar në rezultatet e këtyre intervistave, sondazhi përpiloi një listë të pengesave të mundshme me të cilat mund të ballafaqohen gratë për pjesëmarrjen e tyre në procesin e dialogut

⁷ Shih fusnotën 2.

(shih Tabelën më poshtë për të gjitha përgjigjet). Veçanërisht, sondazhi parashtrroi pyetjen: **“Sa mendoni se mungesa e pjesëmarrjes së grave në Dialog ndërlidhet me...”** ndjekur nga një numër i deklaratave.

Sa mendoni se mungesa e pjesëmarrjes së grave në Dialog ndërlidhet me:	Fuqimisht pajtohem	Pajtohem	Nuk pajtohem	Fuqimisht nuk pajtohem	Nuk di/nuk kam mendim
Grave u mungon motivimi për t'u përfshirë në procesin e dialogut.	4.9%	36.3%	38.9%	10.2%	9.7%
Është e vështirë për gratë të përkushtohen në dialog.	4.9%	22.7%	48.4%	16.9%	7.2%
Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë.	4.2%	11.3%	43.8%	35.6%	5.1%
Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse përfaqësuesit kryesor politikë dominohen nga burrat.	12.5%	50.5%	19.9%	6.8%	10.4%
Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse qeverisë i mungon një strategji për të mbështetur angazhimin e grave në dialog.	13.8%	46.8%	17.2%	7.7%	14.4%
Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse.	9.1%	29.2%	36.0%	16.1%	9.6%
Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirjen gjinore në procesin e dialogut.	7.4%	29.3%	23.7%	7.1%	32.4%

Rezultatet nga mostra e përgjithshme tregojnë renditjen vijuese bazuar në përgjigjet e respondentëve me 'fuqimisht pajtohem' ose 'pajtohem' me deklaratat:

- Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse përfaqësuesit kryesorë politikë dominohen nga burrat (63%);
- Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse qeverisë i mungon një strategji për të mbështetur angazhimin e grave në dialog (61%);
- Grave u mungon motivimi për t'u përfshirë në procesin e dialogut (41%);
- Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse (38%);
- Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirjen gjinore në procesin e dialogut (37%);

- Është e vështirë për gratë të përkushtohen në dialog (28%);
- Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë (16%).

Siç shihet nga sa mësipër, lidhur me pengesat për pjesëmarrjen e grave në Dialog, shumica e pjesëmarrësve (63%) theksojnë dominimin e politikës nga përfaqësuesit/aktorët meshkuj; kjo pasohet nga zgjedhja e dytë (61%), e cila nënvizon mungesën e një strategjie nga qeveria për të mbështetur angazhimin e grave në Dialog. Sa i përket pengesave të tjera për pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut, mbështetja për pengesat e tjera varion nga (41%) në lidhje me mungesën e motivimit të grave për t'u përfshirë në dialog deri në (16%) perceptimin e Dialogut si një negociim të vështirë që është vetëm për burrat.

Vlerësimi ndaras i mostrave shqiptare dhe serbe mbi përgjigjet 'plotësisht pajtohem' dhe 'pajtohem' tregon këtë renditje:

- Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse përfaqësuesit kryesorë politikë dominohen nga burrat (shqiptarët: 63% vs. serbët: 63%);
- Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse (shqiptarët: 37% vs. serbët: 56%);
- Grave u mungon motivimi për t'u përfshirë në procesin e dialogut (shqiptarët: 42% vs. serbët: 39%);
- Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse (shqiptarët: 37% vs. serbët: 46%);
- Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirjen gjinore në procesin e dialogut (shqiptarët: 36% vs. serbët: 45%);
- Është e vështirë për gratë të përkushtohen në dialog (shqiptarët: 27% vs. serbët: 34%);
- Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë (shqiptarët: 13% vs. serbët: 41%).

- Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse qeverisë i mungon një strategji për të mbështetur angazhimin e grave në dialog (shqiptarët: 62% vs. serbët: 51%).

4. Analiza bazuar në dallimet gjinore

Një këndvështrim i përgjigjeve në shumë pyetje të sondazhit të prezantuar në Seksionet 3.1-3.4 tregon se një numër i madh i përgjigjeve janë 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Ky model i përgjigjeve është i ngjashëm si në mostrën shqiptare ashtu edhe në atë serbe. Rrjedhimisht, kemi zbatuar analiza mbi dallimet gjinore për të kuptuar më mirë burimin e përgjigjeve në lidhje me këtë alternativë. Vini re se mostra e këtij studimi përbëhet nga një mbi-përfaqësim i grave (58%) krahasuar me regjistrimin e popullsisë më 2011 (50%).

Analiza aktuale u përqendrua në disa pyetje kryesore që kishin përgjigje me mbi $\leq 20\%$ në alternativën 'nuk di/nuk kam mendim' për këtë çështje. Në mënyrë specifike, 32% e respondentëve gra krahasuar me 16% burra u përgjigjën me alternativën 'nuk di/nuk kam mendim' në pyetjen 'Sa jeni të kënaqur me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?' Pastaj, 52% e respondentëve gra krahasuar me 28% burra u përgjigjën me alternativën 'nuk di/nuk kam mendim' në pyetjen 'Sa jeni të kënaqur me marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit mes Kosovës dhe Serbisë nën lehtësimin e BE-së?' 28% e respondentëve gra krahasuar me 10% burra u përgjigjën me alternativën 'nuk di/nuk kam mendim' në pyetjen 'Aktualisht, takimet e dialogu në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuara nga BE-ja përfaqësohen vetëm nga përfaqësues të qeverisë nga niveli më i lartë (d.m.th., kryeministri dhe zëvendëskryeministri). A pajtoheni që ekipi i Kosovës të përfaqësohet vetëm nga përfaqësues të nivelit më të lartë qeveritar?' 21% e respondentëve gra krahasuar me 9% burra u përgjigjën me alternativën 'nuk di/nuk kam mendim' në pyetjen 'A mendoni se qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje që të përfshijë përfaqësues të tjerë (p.sh., përfaqësues nga partitë politike opozitare, shoqëria civile, akademia, etj.) në takimet e dialogut në Bruksel?'

Testet chi-square në të gjitha këto pyetje treguan për dallime gjinore që ishin në nivel statistikisht të rëndësishëm ($p < .001$). Këto rezultate mund të sugjerojnë që (a) gratë krahasuar me burrat në Kosovë, në përgjithësi janë më pak të preokupuara me çështjet e parashtruara në sondazh; ose (b) pikëpamjet e grave për çështjet e shtruara në sondazh mund të jenë më pak të kristalizuara, prandaj, përgjigjja 'nuk di/nuk kam mendim' tregon pasigurinë e tyre në përgjigje. Derisa këto interpretime duhet të merren me rezervë, hulumtime vijuese duhet të bëhen për të kuptuar më mirë dallimet gjinore për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe pjesëmarrjen e grave në Dialog.

Për më tepër, kemi analizuar nëse ekzistojnë dallime gjinore në deklaratat lidhur me faktorët frenues për pjesëmarrjen e grave në procesin e dialogut (shih tabelën më poshtë). Rezultatet nga testet chi-square tregojnë dallime të rëndësishme gjinore ($p < .05$) në deklaratat: (a) *Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë* (ky perceptim ishte më mbizotërues te burrat se gratë); (b) *Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse* (ky perceptim ishte më mbizotërues te gratë se burrat); (c) *Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirjen gjinore në procesin e dialogut* (ky perceptim ishte më mbizotërues te gratë se burrat).

*ZËRI I POPULLIT RRETH 'SHTEGUT TË PAQES' NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË:
SHPALOSJA E ROLIT TË GRAVE*

	Fuqimisht pajtohem/pajtohem		Fuqimisht nuk pajtohem/nuk pajtohem		Nuk di/nuk kam mendim	
	M	F	M	F	M	F
Sa mendoni se mungesa e pjesëmarrjes së grave në Dialog ndërlidhet me:						
Grave u mungon motivimi për t'u përfshirë në procesin e dialogut.	38%	44%	52%	47%	10%	10%
Është e vështirë për gratë të përkushtohen në dialog.	30%	26%	64%	26%	7%	8%
Dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë.	18%	14%	79%	80%	4%	6%
Gratë nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse përfaqësuesit kryesor politikë dominohen nga burrat.	64%	62%	27%	27%	9%	11%
Grat nuk janë të përfaqësuara në dialog sepse qeverisë i mungon një strategji për të mbështetur angazhimin e grave në dialog.	61%	61%	27%	23%	12%	16%
Shoqëria në Kosovë i përjashton gratë nga të gjitha proceset vendimmarrëse.	32%	43%	60%	46%	9%	10%
Fajin e kanë përfaqësuesit ndërkombëtarë sepse nuk vendosin kritere për përfshirjen gjinore në procesin e dialogut.	37%	37%	38%	25%	25%	38%

5. Përfundime

Ky sondazh kishte tre qëllime. Së pari, qëllimi ishte të kuptoj perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me procesin aktual të dialogut dhe marrëveshjen më të fundit të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shkurt 2023) dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit (mars 2023). Së dyti, qëllimi ishte të kuptoj qëndrimet e qytetarëve në lidhje me përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës dhe mbështetjen ose mungesën e saj për përfshirjen e përfaqësuesve tjerë, me përqendrim të veçantë tek gratë në ekipin e dialogut si përfaqësuese/ndërtuese të paqes. Tre, qëllimi ishte të kuptoj faktorët që pengojnë gratë për pjesëmarrje në procesin e dialogut. Një mostër e përgjithshme prej 1108 respondentëve (89% shqiptarë, 9% serbë dhe 2% nga grupet tjera etnike) përbëjnë mostrën tonë përfaqësuese të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

Sondazhi shpërfaq se shumica e popullsisë në Kosovë *nuk janë të kënaqur me procesin e dialogut aktual* ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, **49%** nga

të gjithë respondentët nuk janë të kënaqur me procesin aktual të dialogut. **46%** nga shqiptarët dhe **80%** nga serbët ishin 'shumë të pakënaqur' ose 'të pakënaqur' në lidhje me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një numër i rëndësishëm i mostrës shqiptare nuk kishin ndonjë mendim për këtë çështje (26%). Shqiptarët dhe serbët treguan një model të ngjashëm të përgjigjeve sa i përket arsyeve në lidhje me pakënaqësinë me procesin e dialogut:

- Nuk ka perspektivë për hapa konkret drejt Integritimit Evropian (60% e shqiptarëve përkundrejt 68% të mostrës serbe);
- Është e pamundur të arrihet njohje globale e Kosovës në rrethanat aktuale (64% e shqiptarëve përkundrejt 74% të mostrës serbe);
- Pavarësia e Kosovës nga Serbia nuk do të njihet në rrethanat aktuale (74% e shqiptarëve përkundrejt 79% të mostrës serbe);
- Nuk do të ketë prosperitet ekonomik për 3-5 vitet e ardhshme (54% e shqiptarëve përkundrejt 73% të mostrës serbe);
- Nuk është e mundur të kemi raporte paqesore me Serbinë në status kuonë aktuale (68% e shqiptarëve përkundrejt 51% të mostrës serbe);
- Problemet e brendshme ndërmjet komunitetit shqiptar dhe serb nuk mund të zgjidhen në rrethanat aktuale (63% e shqiptarëve përkundrejt 91% të mostrës serbe).

Përkundër pakënaqësisë me procesin aktual të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, opinioni duket të jetë i ndarë nëse *Dialogu duhet të vazhdoj në formatin aktual për 5 vitet e ardhshme*. Në përgjithësi, **45%** nga mostra e përgjithshme treguan mbështetje 'deri diku' ose 'tepër shumë' dhe **32%** 'aspak' ose 'shumë pak' për vazhdimin e dialogut në formatin aktual në formatin aktual për 5 vitet e ardhshme. Një numër i rëndësishëm nga mostra shqiptare nuk patën ndonjë mendim për këtë çështje (24%).

Sa i përket *marrëveshjeve*, ekziston një mbështetje e vogël (**15%** u përgjigjën me 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur') për marrëveshjen më të fundit të Brukselit dhe aneksin e saj të zbatimit të Ohrit mes Kosovës dhe Serbisë. Shumica e respondentëve shqiptarë dhe serbë nuk ishin të kënaqur me marrëveshjen më të

fundit të Brukselit (**43%** shqiptarë dhe **61%** serbë). Ndryshe, derisa shumica e shqiptarëve *nuk e mbështeti* (**53%** u përgjigjën me 'fuqimisht nuk pajtohem' ose 'nuk pajtohem'), krahasuar me shumicën e serbëve që e mbështeti (**43%** u përgjigjën me 'fuqimisht pajtohem' ose 'pajtohem') dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe me kusht që Kosova eventualisht të ketë qasje/anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare.

Sa i përket përfaqësimit të ekipit të dialogut të Kosovës, ekziston pak mbështetje (në përgjithësi, **34%**) për përfaqësimin e ekipit të dialogut të Kosovës vetëm nga përfaqësuesit më të lartë qeveritar dhe mbështetje e konsiderueshme (në përgjithësi, **66%**) për përfshirjen e përfaqësuesve të tjerë në ekipin e dialogut. Mbështetja është edhe më e madhe (në përgjithësi, **82%**) për përfshirjen e grave në Dialog dhe emërimin e një gruaje (në përgjithësi, **82%**) për të udhëhequr procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Sa i përket pengesave për pjesëmarrjen e grave në Dialog, shumica e pjesëmarrësve (**63%**) treguan për dominimin e politikës nga përfaqësues burra dhe (**61%**) për mungesën e strategjisë nga qeveria për mbështetjen e angazhimit të grave në Dialog si pengesat kryesore për pjesëmarrje në Dialog. Ekziston një frekuencë më e vogël për pengesat tjera që variojnë nga (**41%**) mungesa e motivimit të grave për angazhim në Dialogu deri më (**16%**) perceptimi se dialogu përfshin negociata të vështira që vetëm burrat mund t'i bëjnë.

